



Në bazë të nenit 3, par.1, pika b të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000 dhe të nenit 19, par.1, pika b të Statutit dhe të Rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 30.05.2006 merr

V E N D I M

MBI CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E TRI OBJEKTEVE TË TËRËSISË SË PËRBASHKËT (KOLEKTIVE) NË FSHATIN LLAPLE-SELLË

Neni 1

Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e 3 (tri) objekteve të tërësisë së përbashkët (kolektive) në fshatin Llaple-Sellë .

Neni 2

Lokacioni për ndërtimin e objektit sipas këtij Vendimi, përfshinë pjesën e ngastrës kadastrale nr. 295, 511 dhe 509, Zona kadastrale Llaple-Sellë, në sipërfaqe përafërsisht 153.08 arë, e evidencuar si pronë shoqërore- pasuri e fshatit, me destinim “sipërfaqe e lirë – gjelbërim”.

Neni 3

Destinimi i caktuar i lokacionit sipas këtij Vendimi, do të inkorporohet në planin e ardhshëm zhvillimor të komunës së Prishtinës.

Neni 4

Ky Vendim paraqet bazë për dhënien e pëlqimit në lokacion, lëshimin e lejes urbanistike dhe lejimin e ndërtimit të objekteve investive, për të cilin është caktuar lokacioni sipas këtij Vendimi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë dhe Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë i Komunës së Prishtinës, do të kryejnë veprime nga përgjegjësia e tyre e caktuar për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01.Nr.353-268, më 30.05.2006

KRYETARI I KUVENDIT

Ismet Beqiri